

## KODI I ETIKËS

### I URDHRIT TË MJEKUT VETERINAR TË SHQIPËRISË

#### Dispozita të Përgjithëshme

Kodi i Etikës përmbanë vlerat dhe parimet e sjelljes së drejtë, që lidhen me detyrimet dhe të drejtat e profesioneve të mjekëve veterinarë, farmacistëve veterinarë, teknikëve veterinarë dhe teknikëve të insiminimit në veprimtarinë e tyre të përditëshme për kujdesin ndaj shëndetit dhe mirëqenjes së kafshëve, dhe të përmbushjes së detyrimeve të shëndetit publik veterinar, për mbrojtjen e jetës së njeriut nga sëmundjet zoonotike dhe produkteteve me origjinë nga kafshët.

Kodi i Etikës Profesionale të Mjekut Veterinar, ashtu si Kodi Evropian i Sjelljes i Federatës Veterinare Europiane shpreh vlerat profesionale, morale-etike dhe standardet e profesionit të veterinerit dhe tregon pikëpamjet që duhet të kihen parasysh në zbatimin e këtyre standardeve.

Kodi i Etikës Profesionale të Mjekut Veterinar, Farmacitit Veterinar, e Teknikut Veterinar dhe Teknikut të Insiminimit (në vijim: *antarët e UPMVSH*) mbështetet në ligjin nr. 113/2015: “Për Urdhrin Profesional të Mjekut Veterinar, ligjin nr. 10 465 datë 19/04/2011:” Për Shërbimin Veterinar në Republikën e Shqipërisë”, ligjit 152/2013:”Për Statusin e Nëpunësit Civil”, ligjin Nr.10 171, datë 22.10.2009 “Për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë”, ndryshuar me Ligjin Nr. 10 470, datë 13/10/2011 “Për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë” si dhe të gjitha aktet e tjera nënligjore,

#### Neni 1

1. Antarët e UPMV janë profesionistë të shëndetit e mirëqenjes së kafshëve, farmacive veterinarë dhe shëndetit public veterinar, të pajisur me diplomë, të njohur nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, dhe të regjistruar në Urdhrin Profesional të Mjekut Veterinar të Shqipërisë.
2. Antarët e UPMV realizojnë kujdesin e shëndetit dhe mirëqenjes së kafshëve, farmacive veterinarë dhe shëndetit public veterinar, përmes ndërhyrjeve specifike, të pavarura e plotësuese, nëpërmjet bashkëpunimit:fermerë, klinika, spitale veterinarë, laboratorë, farmaci veterinarë.
3. Përgjegjësia e anëtarëve të UPMV qëndron në parandalimin dhe lehtësimin e dhimbjeve,në aspektin kurativ, edukimin veterinar, në respektin për jetën, shëndetin dhe mirëqenjen e kafshës.
4. Antarët e UPMV për të kryer në mënyrë të ligjshme profesionin duhet të zbatojnë me korrektësi kërkesat e Nenit 7 të ligjit të sipërpërmëndur për tu regjistruar në UPMV dhe për të zbatuar me korrektësi kërkesat e Statutit dhe të Kodit të Etikës Profesionale.

5. Kodi i Etikës i anëtarëve të UPMV i udhëheq ata në zhvillimin e identitetit profesional dhe në angazhimin për një sjellje të përgjegjshme nga ana etike dhe përbën një mjet komunikimi që informon fermerin apo klientin mbi marrëdhënjet reciproke ndërmjet tyre.
6. Antarët e UPMV, me pjesmarrjen në këtë grupim profesional pranojnë vlerat dhe parimet që përmban Kodi i Etikës Profesionale si dhe angazhohen për t'i zbatuar ato në sjelljen e përditëshme.

## **Neni 2**

### **Detyrimet e Etikës Profesionale**

1. Antarët e UPMV e konsiderojnë shëndetin dhe mirëqenjen, si një të mirë për kafshën dhe për interesat e saj.
2. Antarët e UPMV angazhohen për kujdesin dhe shëndetin me anë të parandalimit, kurimit, rehabilitimit dhe lehtësimit të vuajtjeve të kafshës.
3. Antarët e UPMV kujdesen në mënyrë të njëjtë për të gjithë klientët, pavarësisht nga mosha, specia dhe nga lloji i sëmundjes.
4. Antarët e UPMV janë profesionalisht përgjegjës për ushtrimin e profesionit dhe janë të përgjegjshëm për atë që bëjnë dhe atë që nuk bëjnë.
5. Antarët e UPMV inkurajohen që të dëgjojnë këshillat e kolegëve eprorë dhe drejtuesve, por kur ata përballen me konflikte në ushtrimin e përgjegjësisë, ata duhet të ushtrojnë aftësitë e tyre profesionale dhe të zgjedhin rrugën e duhur për të vepruar duke e përdorur këtë Kod si bazën e marrjes së vendimit.
6. Antarët e UPMV duhet të rrezatojnë kulturë dhe besim tek fermeri, me paraqitjen dhe me veshjen e tyre. Ata janë të detyruar që në vendin e punës, farmaci, klinikë, spital apo fermë të paraqiten me uniformën e caktuar, e cila duhet të jetë e pastër dhe e rregullt për kryerjen e detyrës dhe kartën me identitetin profesional gjithnjë të dukëshme.
7. Antarët e UPMV të manifestojnë sjellje korrekte brenda normave dhe rregullave të kryerjes së detyrës, komunikimi me qetësi, me siguri dhe brenda kompetencave të caktuara me fermerin apo pronarin e kafshës. Shkelja apo tejkalim i këtyre normave është i dënueshëm.
8. Antarët e UPMV nuk duhet kërkojnë, të pranojnë, nxisin apo ndërmetojnë në asnjë formë ryshfet për punën e kryer, për shërbime a praktika veterinare të financuar nga shtetit apo institucione të tjera donator, në të kundërtën ata mbajnë përgjegjësi ligjore.
9. Në rastet e konfliktit të shkaktuara nga ndryshimet e thella etike, antarët e UPMV angazhohen për të gjetur zgjidhjen e duhur, përmes dialogut, vullnetit të mirë me parimet etike dhe me ndërgjegjen profesionale.
10. Për të gjetur rrugëzgjdhje dhe në rastet e konfliktit antarët e UPMV venë në plan të parë interesat e klientit, fermerit apo pronarit të kafshës.

11. Antarët e UPMV ruajnë emrin dhe figurën morale, duke qëndruar larg veseve që i dëmtojnë si: alkoli, droga, imoraliteti. Rastet e shthurjes morale, paraqitjes në punë në gjendje të dehur apo nën efektin e substancave të jashtëligjshme, ndëshkohen.
12. Antarët e UPMV i kërkohet të njohin dhe zbatojnë Kodin e Etikës Profesionale dhe të bëjë një betim që ai/ajo do ta zbatojë plotësisht, me përkushtim, drejtësi dhe ndershmëri.
13. Antarët e UPMV mund të zhvillojnë forma vullnetare për kryrje të praktikës veterinare, por me përgjegjësi profesionale dhe konform ligjeve në fuqi dhe zbatimit të këtij Kodi.
14. Antarët e UPMV në situata urgjence apo fatkeqësi natyrore duhet të japin ndihmën në kohën e duhur për të garantuar asistencën e nevojshme, mbajnë përgjegjësi në rast të mosdhënies së saj.
15. Antarët e UPMV duhet të veprojnë në atë mënyrë që promovon besimin te publiku dhe sigurinë te ky profesion.
16. Antarët e UPMV, në raste ngjarjesh madhore, fatkeqësish, vihen në dispozicion të autoriteteve kompetente për të dhënë kontributin e tyre sipas rastit.
17. Veprimi profesional gjatë kryerjes së praktikës veterinare, nuk duhet të jetë i kushtëzuar nga presionet ose interesat personale që rrjedhin nga persona, operatorë të tjerë, shoqata, apo organizma të ndryshme.
18. Antarët e UPMV janë përgjegjës gjatë ushtrimit të detyrës në bazë të kompetencave të përcaktuara nga ligji i shërbimit veterinar si dhe aktete e tjera ligjore e nënligjore. Në rast të shkeljes apo tejkalimit të tyre, që shkaktojnë dëmtime në shëndetin e kafshës, ndëshkohen. Në çdo rast, kur e shohin të arsyeshme, i kërkojnë ndihmë profesionistëve të tjerë.
19. Për antarët e UPMV, që hyjnë në këtë profesion, Kodi i Etikës identifikon parimet themelore të profesionit të veterinerit, shërben si një mjet edukues dhe siguron udhëheqje.
20. Për antarët e UPMV, që janë duke e ushtruar këtë profesion, Kodi i Etikës siguron bazat e veta të monitorimit në ushtrimin e profesionit dhe shërben si një udhëheqës për veterinerët, në raport me përmbushjen e detyrimeve të tyre profesionale.
21. Për antarët e UPMV që janë jashtë këtij profesioni, Kodi i Etikës siguron udhëzime për të vlerësuar standardet e sjelljes, që priten të manifestohen gjatë ushtrimit të profesionit.
22. Për antarët e regjistruar në Urdhrin Veterinar, Kodi i Etikës shërben si një standard, mbi të cilin mund të trajtohen ankesat dhe shqetësimet mbi punën e veterinerit, duke treguar gjykim profesional në të gjitha rastet e ushtrimit të profesionit.
23. Antarët e UPMV duhet të përdorin gjykimin e tyre profesional nëse duhet të njoftojnë Këshillin Kombëtar të Urdhrit Profesional të Mjekut Veterinar, nëse sjellja ose kompetenca e një kolegu po ndikon negativisht në kujdesin e klientit ose po lëkund besimin e publikut në këtë profesion.
24. Kodi i Etikës nuk është shterues, pra, që në lloje të ndryshme rrethanash, Kodi mund të përcaktojë se si duhet të menaxhohet çdo situatë.

### **Neni 3**

#### **Formimi i vazhdueshëm profesional i antarëve të Urdhrit**

Antarët e UPMV duhet të përfitojnë aftësitë dhe njohuritë duke marrë pjesë në aktivitete të besueshme, të jashtë dhe të vazhdueshme të zhvillimit profesional që zhvillojnë dhe konsolidojnë kompetencat dhe performancën e tyre, me qëllim që të njohin praktikën e reja në profesionet përkatëse për të rritur cilësinë e shërbimit veterinar,

1. Antarët e UPMV të ndërmarrin të gjitha hapat e nevojshme për të shmangur kufizimet lidhur me ushtrimin e kompetencave apo burimet e disponueshme për aftësimin e tyre për të kryer detyrën në standarde të pranueshme;
2. Antarët e UPMV të jenë të përgjegjshëm e të sigurohen që ushtrimi i profesionit prej tyre është në përputhje me standardet e parashtruara nga ky Kod, në përputhje me të gjitha ligjet dhe standardet të aplikueshme në shërbimin e tyre veterinar.
3. Antarët e UPMV të mbajnë dhe të kujdesen për të dhëna të qarta klinike, në mënyrë që çdo veterinar tjetër t'i ketë të qarta në çdo kohë.
4. Antarët e UPMV duhet të mbajnë të përditësuar njohuritë e tyre mbi ligjet që ndikojnë në punën e tyre, në detyrat si punonjës, zotërues të bizneseve apo tregtarë të medikamenteve veterinarë.
5. Në rast të mospërputhshmërisë, ata duhet të jenë rast trajtimi nga Komisioni i Disiplinës, i cili do të ushtrojë detyrat e tij në përputhje me Kapitullin IV “Masat Disiplinore dhe Pretendimet” (Ligji nr. 113/2015 dhe Ligji Nr. 10465, datë 29.9.2011)
6. Antarët e UPMV duhet të njohin mire ligjet bazë të Shërbimit Veterinar, të ushqimit, ligjin Nr.10 171, datë 22.10.2009 “Për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë”, ndryshuar me Ligjin Nr. 10 470, datë 13/10/2011 “Për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë” si dhe të gjitha aktet e tjera nënligjore,
7. Antarët e UPMV marrin pjesë në formimin e vazhdueshëm profesional, nxisin kërkimin, informimin dhe komunikimin me qëllim që t'i përhapin dhe zbatojnë përvojat e reja, brenda dhe jashtë vendit.
8. Antarët e UPMV duhet të njohin dhe zbatojnë me siguri profesionale urdhërat dhe rregulloret e Ministrisë së Bujqësisë lidhur me Strategjitë e luftimit të sëmundjeve, planeve të konvergencës etj,
9. Antarët e UPMV mbajnë përgjegjësi në bazë të kompetencave të përcaktuara nga legjislacioni shqiptar në fushën e veterinarisë, ushqimit dhe akteve të tjera ligjore e nëse e shikon të nevojshme për ndërhyrje ose për konsulencë të mëtejshme u drejtohet profesionistëve ose eprorëve të tij.
10. Antarët e UPMV nuk duhet të shpërdorojnë mundësitë që u krijon profesioni dhe nuk duhet të bëjë eksperimente pa baza ligjore, të cilat rrezikojnë shëndetin dhe jetën e kafshës.

#### **Neni 4**

#### **Marrëdhëniet e antarëve të Urdhrit me klientët**

1. Antarët e UPMV në ushtrimin e profesionit duhet të nxitin një komunikim të frytshëm, që të arrijnë të fitojnë besimin dhe respektin e klientit për profesionin e veterinerit, si dhe të plotësojnë kërkesën që i njej klientit të drejtën për të zgjedhur.
2. Antarët e UPMV duhet të ndërveprojnë me klientin, duke nxitur komunikim frytshëm dhe t'u japin klientëve informacionin që ata kanë nevojë, në mënyrë që klienti ta kuptojë dhe t'i japë leje për trajtimin e propozuar.
3. Antarët e UPMV duhet të nxitin përmes promovimit dhe edukimit, mënyrat dhe format e përhapjes të një kulture veterinarë për sigurimin e raporteve të drejta ndërmjet shërbimit veterinar, operatorëve në terren dhe fermerit.
4. Antarët e UPMV të dëgjojnë dhe informojnë personin ose fermerin, duke vlerësuar nevojat e kujdesjeve për kafshën, duke i mundësuar atij të shprehë zgjidhjet e tij personale.
5. Antarët e UPMV të respektojnë mendimin e klientit, dhe lehtësojnë raportet me kolegët e tjerë, që përfshihen në planin e kurimit.
6. Antarët e UPMV kanë për detyrë të jenë të informuar për planin diagnostikues e terapeutik, për ndikimin dhe lidhjen që këto kanë mbi programin e kujdesjeve veterinarë.
7. Antarët e UPMV të ndihmojnë klientin në zgjedhjet terapeutike, duke garantuar informacion lidhur me planin e kujdesjeve veterinarë, i cili vazhdon deri kur klienti bëhet i ndërgjegjshëm për zgjedhjen e të drejtës së tij.
8. Antarët e UPMV duhet të garantojnë vazhdueshmërinë e kujdeseve veterinarë deri në përmbushjen e misionit të mbrojtjes së mirëqenies dhe lehtësimin e vuajtjeve të kafshëve në lidhje me pesë kërkesat bazë: Ushqimin dhe ujin e mjaftueshëm, shtimin e përshtatshëm mundësinë për të shfaqur sjellje normale, trajtimin e duhur fizik, mbrojtje e diagnozë të shpejtë dhe trajtimin e duhur të plagëve dhe sëmundjeve
9. Antarët e UPMV e konsiderojnë ndihmën si një zgjidhje të bashkërenduar, duke marrë parasysh interesin e klientit.
10. Antarët e UPMV duhet të vënë në përdorim të gjitha mjetet e ligjshme, duke njoftuar edhe autoritetet kompetente, kur vëren keqtrajtime apo mangësi në të drejtën e klientit dhe që mund t'i sjellim dëm atij.
11. Antarët e UPMV mbikqyrin të drejtën e mbajtjes së kufijve të tejkalimeve terapeutike, për medikamente të cilat janë jo të përshtatshme me konceptin e rëndësisë së jetës të kafshës dhe me pasoja negative për shëndetin public veterinar.

## **Neni 6**

### **Raportet profesionale të antarëve të Urdhërit**

1. Antarët e UPMV duhet t'i trajtojnë me profesionalizëm dhe respekt kolegët dhe mbështetje të ndërsjellë, duke mos kryer kritika dashakeqëse ose të pabazuara për ta, që mund të lëkundë besimin e publikut dhe diskretitojë profesionin.
2. Antarët e UPMV kur rekomandojnë një klient te një veteriner tjetër me eksperiencë apo paisje/aparatura të veçanta, të dy veterinerët janë të besueshëm për klientin dhe konsiderohen si përgjegjës për manaxhimin e vazhdueshëm të rastit në fjalë.
3. Antarët e UPMV kujdesen për dinjitetin e tyre dhe të kolegëve nëpërmjet sjelljeve, të cilat shprehin respekt dhe solidaritet, në procesin e kurimit dhe kujdesjeve veterinare.
4. Antarët e rinj të UPMV /ose pa eksperiencë duhet të mbështeten vazhdimisht.
5. Antarët e UPMV kanë detyrë të vetvlerësojnë, të parashtrojnë veprimet e tyre dhe të verifikojnë kujdesjet veterinare , në vijimësi.
6. Antarët e UPMV në ushtrimin e autonomisë i përmbahen normave dhe sjelljeve që përmban Kodi i Etikës Profesionale.
7. Antarët e UPMV kujdesen për kualifikimin e tyre profesional dhe nëpërmjet respektimit të normave, që rregullojnë veprimtarinë e Sherbimit Veterinar Shqiptar dhe Statusin e Nëpunësit .
8. Antarët e UPMV janë të detyruar të shënojnë në Kartën e Regjistrimit Profesional , çdo vendim apo sjellje që bie në kundërshtim me Kodin e Etikës.

## **Neni 7**

### **Medikamentet Mjekësore Veterinare**

Antarët e UPMV gjatë përdorimit apo tregëtimit të medikamenteve veterinare duhet të sigurojnë menaxhim efektiv të produktit (ruajtje, raportim të reaksioneve, mbajtjen e integritetit të produktit, etiketimin, sigurinë, siguri në mbajtje);

Antarët e UPMV duhet të mbajnë në konsideratë ndërlikimet e përdorimit të medikamenteve veterinare, përsa i përket rreziqeve të shëndeti public, sigurinë në prodhimin bazë, prodhimet bujqësore, mirëqenien e kafshëve, shëndetin dhe sigurinë profesionale, mjedisin, për të shmangur ose zvogëluar rreziqet;

Antarët e UPMV duhet të japin këshillat e duhura për menaxhimin e mbetjeve dhe mbajtjen nën survejim të kafshëve që përdoren për ushqime

## **Neni 8**

### **Raportet me institucionet**

1. Antarët e UPMV në nivele të ndryshme përgjegjësie duhet të kontribuojnë në dhënjen e propozimeve në orientimin e politikave veterinare dhe në zhvillimin e shërbimit veterinar, për garantimin dhe respektimin e të drejtave të klientit.

2. Antarët e UPMV duhet të sigurojnë dhënien e informacionit dhe të komunikimit të shpejtë dhe të qartë në nivelet përkatëse për emergjencja veterinarë me qëllim që të shmangen në kohë mungesat apo çrregullimet dhe të rikrijohet një situatë të favorshme për klientin.
3. Antarët e UPMV u drejtohen autoriteteve profesionalë kompetentë të cilët janë të aftë të gjykojnë për kujdesjet veterinarë, si dhe për cilësinë dhe efektet mbi klientin.
4. Antarët e UPMV e kanë detyrë dhe të drejtë të informojnë Urdhrin për kushtet që dëmtojnë cilësinë e kujdesjeve veterinarë gjatë ushtrimit të profesionit dhe të kërkojnë mbështetjen e organeve të tij.

### **Neni 9**

#### **Dispozita përfundimtare**

Kodi i Etikës u miratua në mbledhjen e Këshillit Kombëtar me Vendim nr 10, datë 23/06/2016 dhe hyn në fuqi menjëherë

**P R E S I D E N T I**

**Thoma PURIQI**